



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar këkesën me nr. prot. 3845 të datës 28.12.2017, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës jep mendim dhe pajtohet me kandidaturat e propozuara nga Paneli Seleksionues për përzgjedhjen e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 07/49 të datës 16.09.2015, lidhur me Bordin e Ndërmarrjes Publike NPH "Ibër Lepenci" Sh.A

1. Ndryshohet dhe plotësohet nënpika 1.4. e vendimit nr. 07/49 të datës 16.09.2015, si në vijim:
1.4. Muharrem Xhemajli;
2. Pas nënpikës 1.5 të vendimit nr. 07/49 të datës 16.09.2015, shtohet nënpika 1.6, si në vijim:
1.6. Liridon Zogiani.
3. Ky vendim paraqet pjesë përbërëse të vendimit nr. 07/49 datë 16.09.2015.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet pika 1.2 dhe 1.3 e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/98 datë 29 qershor 2016 për emërimin e zëvendës drejtorëve në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror; 1.2. Bujar Ejupi, zëvendës drejtor për shërbime administrative financiare dhe 1.3. Ersen Shileku, zëvendës drejtor për shërbime operative.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Bazuar në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, me datë 20.05.2016, Ministria e Infrastrukturës ka hapur konkurs për rekrutimin në pozitën e Zëvendës Drejtorëve për Shërbime të Navigacionit Ajror. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes nga ana e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, dhe lëshimit të rekomandimit përkatës nga Ministria e Infrastrukturës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2016 ka nxjerrur vendimin me nr. 06/98 për vazhdimin e mandatit të drejtorit, si dhe emërimin e z. Bujar Ejupi, zv. Drejtor për shërbime Administrative Financiare dhe z. Ersen Shileku, zv. Drejtor për Shërbime Operative në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së kandidatëve kundër vendimit të Komisionit Përzgjedhës ka aprovuar ankesën e tyre dhe me Vendimin nr. A/02/587/2016 dhe A-02/593/2016 ka shfuqizuar vendimin nr.6355 të datës 02.12.2016 dhe vendimin nr.6354 e datës 02.12.2016 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, dhe ka anuluar procesin e rekrutimit dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Zv. Drejtorit për Shërbime Administrative Financiare dhe Zv. Drejtorit për Shërbime Operative të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, duke obliguar Ministrinë e Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Çështja është inicuar në konflikt administrativ nga Ministria e Infrastrukturës duke kërkuar të vendoset masë e përkohshme që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, por që një gjë e tillë është refuzuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me vendimin nr.A.nr.720/17 dt. 08.05.2017 si dhe është vërtetuar i njeiti vendim nga Gjykata e Apelit të Kosovës me vendim AA.nr.270/2017 të datës 23.06.2017. Prandaj, duke marr parasysh se zbatimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës është obligim i të gjitha institucioneve të administratës Publike, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur mundë të fillojë konflikt administrativ në pajtim me ligjin në fuqi.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin nr. 05/L-063 dhe me Ligjin nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për aprovimin e buxhetit për komunën e Lipjanit pas aprovimit të buxhetit për vitin 2018 nga Kuvendi Komunal Lipjan, me datë 18.12.2017.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Lipjanit.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin bashkë me tabela t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe të Ligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rritja e pagave duke filluar nga 01 Janar 2018 për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin paga nga buxheti i Republikës së Kosovës prej 4% mbi pagën bazë duke përfshirë mjetet financiare prej 30 euro për punëtorët e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës si dhe 44 euro për punëtorët shëndetësorë. Rritja aplikohet edhe në shpërblimin e anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
2. Përfshihen nga pika 1. e këtij vendimi të gjitha pozitat që ndikohen nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/20 i datës 20.12.2017.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Organizatat Buxhetore të ndikuara për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/24

Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin nr. 05/L-063 dhe me Ligjin nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë 54,850.00 (pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro, mbulim i shpenzimeve për manifestimin multikulturor "Flaka e Janarit" 2018, në Komunën e Gjilanit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 232-13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në komunën e Gjilanit në linjën buxhetore 10/651/850/85027 në programin Kulturë, Rini dhe Sport, nën programin shërbimet kulturore në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Gjilanit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Bordi Këshillëdhënës i Agjencisë së Punësimit i Republikës së Kosovës.
2. Bordi Këshillëdhënës do të jetë në këtë përbërje:
 - 2.1. Izedin Bytyqi - MPMS;
 - 2.2. Hysnije Maloku - MF;
 - 2.3. Rexhep Bllaca - MTI;
 - 2.4. Veton Alihajdari - MASHT;
 - 2.5. Veton Firzi - MKRS;
 - 2.6. Lah Nitaj - Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve;
 - 2.7. Avni Ajdini - BSPK;
 - 2.8. Safet Gerxhaliu - OEK;
 - 2.9. Sazan Ibrahimimi - Asociacioni i Komunave të Kosovës.
3. Mandati i anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës është tre (3) vjeçar.
4. Takimi i parë i Bordit Këshillëdhënës, deri në përzgjedhjen e kryetarit, udhëhiqet nga anëtari më i vjetër.
5. Kryetari i Bordit Këshillëdhënës zgjidhet me propozimin e anëtarëve të Bordit me shumicë të thjeshte votash përmes votës së fshehtë, në takimin e parë, me mandat prej tre (3) vjetësh.
6. Bordi Këshillëdhënës mblidhet së paku gjashtë (6) herë në vit, në rastet e veçanta, kryetari i Bordit mund të thërras takimet tjera sipas nevojës.

7. Organizimi dhe funksionimi i Bordit Këshillëdhënës përcaktohet me Rregullore të brendshme të punës së Bordit, e cila përgatitet nga anëtarët e Bordit në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe miratohet nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 paragrafëve 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qendrat për Punë Sociale në komunat e Republikës së Kosovës caktohen si institucione përgjegjëse për vlerësimin e kategorive sociale që do të lirohen nga pagesa e premiumeve dhe bashkëpagesave, nëse identifikohen si të varfëra sipas kriteriumeve të Testit të Varfërisë.
2. Obligohen Qendrat për Punë Sociale në komunat e Republikës së Kosovës për zbatimin e Testit të Mjeteve Financiare dhe Testit të Mjeteve të Përafërta.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme (objekteve-investimeve) të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Zonat Kadastrale Nikaj dhe Soponicë, Komuna e Kaçanikut dhe Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ Nr. 31/15 Qershor 2008) dhe të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ Nr. 13/30 Maj 2012), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Qendra Multifunkionale" Sh.A, Mitrovicë.
2. Ndërmarrja Publike Lokale "Qendra Multifunkionale" Sh.A, themelohet me 100% Aksione nga Kuvendi Komunal Mitrovicë.
3. Autorizohet Komuna e Mitrovicës që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NPL "Qendra Multifunkionale" Sh. A. dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme, duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.
4. Komuna e Mitrovicës të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Komuna e Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni ndërministror për shënimin e 550 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.
2. Komisioni përbehet nga:
 - 2.1. Jahja Lluka, këshilltar i Kryeministrit;
 - 2.2. Sekretari i ZKM;
 - 2.3. Ministri i MKRS;
 - 2.4. Sekretari i MKRS;
 - 2.5. Ministri i MASHT;
 - 2.6. Sekretari i MF;
 - 2.7. Përfaqësues nga Presidenca;
 - 2.8. Përfaqësues nga Kuvendi;
 - 2.9. Përfaqësues nga Kuvendi Komunal.
3. Komisioni është i mandatuar t'i bëjë të gjitha parapërgatitjet si dhe agjendën e shënimit të 550 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.12/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Avni Arifi, shëf i stafit të Kryeministrit, emërohet shëf i negociatave me Serbinë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/24

Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 4. e Vendimit të Qeverisë nr. 03/128 të datës 18.01.2017, si në vijim:


“4. Komiteti Drejtues përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve si në vijim:

- 4.1. Ministri i Drejtësisë, kryesues;
- 4.2. Ministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, anëtar;
- 4.3. Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
- 4.4. Ministri për Administrimin e Pushtetit Lokal, anëtar;
- 4.5. Ministri i Financave, anëtar;
- 4.6. Ministri për Integrim Evropian, anëtar;
- 4.7. Përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit, anëtar;
- 4.8. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anëtar;
- 4.9. Përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, anëtar;
- 4.10. Përfaqësues nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, anëtar;
- 4.11. Përfaqësues nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, anëtar;
- 4.12. Përfaqësues nga Agjencia për Barazi Gjinore, anëtar;
- 4.13. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar;
- 4.14. Përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë që ofrojnë asistencë teknike gjatë procesit të implementimit, anëtar.

2. Ndryshohet dhe plotësohet pika 6. e Vendimit të Qeverisë nr. 03/128 të datës 18.01.2017, si në vijim:

“6. Varësisht prej fokusit të reformës së sektorit të të drejtave pronësore, kompetencat të caktuara të kryesimit për çështje specifike të Komitetit Drejtues mund t'i barten një institucioni tjetër përkatës nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete shtesë financiare në vlerën prej 65,000.00 euro, për nëntë (9) OJQ-të e licencuara, të cilat ofrojnë shërbime për mbrojtje të fëmijëve, strehimin e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga nën-programi 00500-Asistenca Sociale kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere, nën-kategoria ekonomike 21200-subvencione për entitete jo publike dhe nën-programi 00600-Sherbimet Sociale kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere, nën kategoria ekonomike 21200-subvencione për entitete jo publike.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që shumën e mjeteve financiare nga pika 1. e këtij vendimi të ndajë në këto shuma për strehimoret/OJQ-të:
 - 1.1. Për strehimoren "Qendra për mbrojtjen dhe rehabilitimin e grave dhe fëmijëve-Liria" në Gjilan, ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1507001000682963;
 - 1.2. Për strehimoren "Qendra për strehimin e grave dhe fëmijëve" në Prizren, ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1404000003714159;
 - 1.3. Për strehimoren "Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve -Raba Voca" në Mitrovicë, ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1160686109000124;
 - 1.4. Për strehimoren "Shtëpia e Sigurt "në Gjakovë, ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1140096956000158;
 - 1.5. Për strehimoren "Qendra për Mirëqenien e Gruas" në Pejë, ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1130062827000156;
 - 1.6. Për strehimoren "Qendra e Gruas-Shtëpia Ime" në Ferizaj, ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1189005918000179;
 - 1.7. Për strehimoren "Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit" në Prishtinë ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1110165139000128;
 - 1.8. Për ofrimin e shërbimeve ditore për fëmijë me aftësi të kufizuar nga OJQ "Pema", ndahet shuma prej 7,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr. 1110337682000183;
 - 1.9. Për ofrimin e shërbimeve rezidenciale për fëmijë nga OJQ "Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve" në Prishtinë, ndahet shuma prej 9,000.00 euro në xhironlogarinë me Nr.1501110000259256.

4. Mjetet financiare të përcaktuara sipas pikës 3. të këtij vendimi do të shfrytëzohen nga strehimoret/OJQ-ët, për financimin e ofrimit të shërbimeve deri në përfundimin e procedurave të shpalljes së thirrjes publike nga MPMS-ja për mbështetje të OJQ-ve për vitin 2018;
5. Për mjetet financiare të shfrytëzuara nga pika 3. e këtij vendimi strehimoret/OJQ-të, janë të obliguara të dorëzojnë raportet narrative dhe financiare në Divizionin për Buxhet dhe Financa në MPMS.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr.2003/15 për Skemën Sociale në Kosovë, të Ligjit nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për Skemën Sociale në Kosovë dhe Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi për përcaktimin e lartësisë së pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale në nivel të rritjes prej 20%, duke filluar nga 01 Janar 2018.
2. Lartësia e pagesës së shumës mujore për ndihmë sociale përcaktohet sipas numrit të anëtarëve dhe vlerës së pikëve.
3. Vlera e një (1) pike është e barabartë me 1.50 euro.
4. Bazuar në numrin e anëtarëve dhe numrin e pikëve që ka familja në Skemën e Ndhimës Sociale, shuma mujore e pagesës për familje do të jetë si vijon:

Familjet sipas anëtarëve	Numri i pikëve	Shuma në €
Një (1) anëtar	40	60.00 €
Dy (2) anëtarë	55	82.50 €
Tre (3) anëtarë	60	90.00 €
Katër (4) anëtarë	65	97.50 €
Pesë (5) anëtarë	70	105.00 €
Gjashtë (6) anëtarë	75	112.50 €
Shtatë (7) anëtarë	80	120.00 €
Tetë (8) anëtarë	85	127.50 €
Nëntë (9) anëtarë	90	135.00 €
Dhjetë (10) anëtarë	95	142.50 €
Njëmbëdhjetë (11) anëtarë	100	150.00 €
Dymbëdhjetë (12) anëtarë	105	157.50 €
Trembëdhjetë (13) anëtarë	110	165.00 €
Katërbëdhjetë (14) anëtarë	115	172.50 €
Pesëmbëdhjetë (15) anëtarë	120	180.00 €

**Familjet që kanë më shumë se 15 anëtarë, për çdo anëtar shtesë marrin nga pesë (5) pikë shtesë.*

5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/24
Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Vënies në Dispozicion të Pasurive të Paluajtshme në Pronësi të Ndërmarrjeve Publike për Zhvillimin dhe Realizimin e Projekteve për Investime Strategjike
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi .
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 17/24

Datë: 12.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Mënyrën dhe Metodat e Verifikimit të Përmbushjes së Kritereve për Përcaktimin e Statusit të Investitorit Strategjik.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi .
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë